



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401596/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me aftësi të kufizuar në Qendrën e Zhvillimit, Vlorë.*

Drejtuar: **Z. Shpëtim GJKA**
Kryetar i Bashkisë

V L O R Ë

Zoti Kryetar,

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të personave me aftësi të kufizuar, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 09.09.2014, inspektuan Qendrën e Zhvillimit, Vlorë.

Ky inspektim u krye në mbështetje të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe vecanerisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut".

"Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise".

Në takimin e bërë me drejtuesit e kësaj qendre, u informuam se aty trajtoheshin persona me aftësi të kufizuar, me diagnoza të ndryshme, nga moshë 2-27 vjeç. Aktualisht strehoheshin 31 persona, nga të cilët 11 janë autikë, në një kohë që kapaciteti i këtij institucioni është për 24 persona.

Kuota ushqimore prej 320 lekë në muaj për çdo person që trajtohet në qendër ishte e mjaftueshme.

Kjo qender përbëhej nga një godinë dy katëshe, e rrethuar me një oborr të madh.

Personeli i kësaj qendre përbëhej nga 24 punonjës, nga të cilët 18 financohen nga Shërbimi Social Shtetëror, ndërsa 6 të tjerë nga Bashkia.

Punonjësja sociale kishte dosje të veçanta për çdo person me aftësi të kufizuar, e cila punonte me plan të përcaktuar mujor për trajtimin e tyre. Shërbimi mjekësor realizoj nga mjeku part0time, Çdo person kishte kartelkën e tij shëndetësore.

Në mure ishin të varura rregullorja e jetës së brendshme dhe standartet që duhet të respektonin punonjësit e qendres. Kutia e ankesave ishte e vendosur në korridor dhe hapej një herë në tre muaj, por nuk ka patur asnjeherë ankesa. Gjithashtu në një vend të veçantë ishin vendosur mjetet kundër zjarrit dhe stafi ishte i trajnuar për rreziqet që mund të vijnë nga rastet e mergjencave civile.

Nga drejtuesit oganizoheshin vazhdimisht aktivitete të ndryshme sociale si: ditëlindje, shëtitje, plazh, etj.

Ambjentet e kësaj qendre ishin të konceptuara në miniapartamente dhe klasa ku mbaheshin dhe mësonin këta persona. Dhomat e fjetjes përbëheshin nga 5-6 krevate, pa lagështirë, me hapësira të mjaftueshme, të pajisura me dysheke, çarcafë, dollape etj.

Monitorimi i standarteve bëhej shpesh nga inspektorë të Shërbimit Social Shtetëror, nga Inspektoriati Punës etj.

Është për t'u vlerësuar përkushtimi i jashtëzakonshëm të stafit për këtë kategori personash.

Gjatë këtij inspektimi u vunë re problematikat e mëposhtme:

- Pjesa e rrugës përpara hyrjes për në qendër, ishte e zënë nga një pikë lavazhi, mbeturina të ndryshme, grupime dherash, etj.
- Lagështira e madhe në katin e parë të godinës.
- Pavarësisht se kjo qendër ishte e pajisur me artikujt horelerike, krevatet dhe dyshekët ishin të papërshtatura për këtë kategori të sëmurësh.
- Në organikën e punonjësve të qendrës, janë 6 kujdestarë, që punojnë me tre turne. Në grupin e vogël, e përbërë nga 9 fëmijë, 6 nga të cilët të paralizuar, punojnë një kujdestar dhe një edukatore. Kjo e papërbalueshme për rehabilitimin e kësaj kategorie, bazuar në standartet e shërbimeve sociale. Për 31 persona janë vetëm 6 kujdestarë.
- Ngrohja realizohej me gaz dhe me rezistenca. Pavarësisht se kaldaja ishte në gjendje pune, përdorej shumë pak, pasi shpenzimet e larta të energjisë elektrike nuk mund të përballoheshin me fondet e parashikuara.
- Duke qenë se në këtë qendër trajtohen persona me diagnoza të ndryshme sëmundjeje, seancat e fizioterapisë duhet të bëhen me grupime sipas diagnozave mjekësore, me qëllim rehabilitimin sa më të shpejtë të tyre.
- Një problem shqetësues ishte edhe ajo e mjekut stomatolog, pasi personat me probleme shëndetësore të ndryshme, nuk i kuron asnjë dentist.

Avokati i Popullit gjykon se krijimi i kushteve të përshtatshme në këto institucione duhet të jetë prioritet i veçantë, pasi kjo kategori duhet të trajtohet

si pjesë e shoqërisë sonë me të drejta të barabarta, pavarësisht gjëndjes së tyre të rëndë shëndetësore.

Sa më lart, në kuadrit e decentralizimit të shërbimeve shoqërore, duke qenë se kjo qendër është nën administrimin Tuaj sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.850 datë 15.12.2006 *“Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave që janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave në.60 datë 01.02.2006 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror”, për t’iu përgjigjur sa më shumë nevojave të personave me aftësi të kufizuara në këtë qendër dhe për të plotësuar një nga standartet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale, siç është pasurimi i rrjetit të shërbimeve dhe rritja e cilësisë së tyre, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”,*

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për:

1. Për rregullimin e pjesës së rrugës përpara hyrjes në këtë qendër.
2. Rikonstruksionin e katit të parë të godinës.
3. Mundësinë për shtimin në organikë me kujdestarë, fizioterapistë, mjek stomatolog me part-time.
4. Zëvendësimin e krevateve dhe dyshekëve ekzistues me krevate me mekanizëm dhe dyshekë specifike për kategorinë e personave që trajtohen në atë qendër.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se,

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI